

U realizua debat publik për tre draft – akte nënligjore



Shkup, 22.01.2015 – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale realizoi një debat public për këto akte nënligjore: Draft-Vendimin për përcaktimin e listës me evenimentet me rëndësi të madhe për opinionin në RM, Draft – Udhëzimi për të drejtën e njoftimit për ngjarjet për të cilat është fituar e drejta ekskluzive për emetimin dhe Draft-Planin për dedikim dhe shpërndarje të kapaciteteve të multipleks operatorit digjital tokësor të rrjetit publik të komunikimit elektronik që ja obligim për emetimin e serviseve programore të radiodifuzorëve.

Debati publik u mbajt me qëllim që Agjencia të diskutojë me përfaqësuesit e radiodifuzorëve në nivel shtetëror, rajonal dhe lokal, përfaqësuesit e ministrive dhe subjekteve tjera relevante për aktet e përmendura dhe tju mundësojë që ata të japin mendime dhe vërejtje, të cilat Agjencia i merr parasysh gjatë miratimit të akteve nënligjore.

